

971 SHKENCA E HAPUR*

Fusha përdoret për shënimin e të dhënave për shkencën e hapur.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA	PËRSËRITSHMËRIA
971	nr
a	r
b	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

971a Të dhënat kërkimore – lloji

Kodi përcakton llojin e të dhënave kërkimore.

a	<i>të dhëna të agreguara/përmbledhëse</i> Të dhënat statistikore, të cilat kanë të bëjnë me klasat, grupet dhe kategoritë e gjëra. Të dhënat janë një mesatare, një shumë ose një derivim tjetër nga të dhënat në nivelin individual, në atë mënyrë që nuk mund të bëhet dallimi midis karakteristikave të individëve brenda këtyre klasave, grupeve ose kategorive (shih shembullin 1). Shembuj: numri i të papunëve dhe mosha e tyre në regjionet e caktuara gjeografike ose të dhënat statistikore në nivel kombëtar për veprat e caktuara penale, të cilat fillimisht janë nxjerrur nga statistikat e qarqeve të veçanta policore.
b	<i>të dhëna për testimin klinik</i> Të dhënat nga studimet kërkimore, në të cilat një ose disa persona klasifikohen në mënyrë prospektive në një ose disa ndërhyrje (që mund të përfshijë një placebo ose një kontroll tjetër), në bazë të të cilave vlerësohen efektet e këtyre intervenimeve në rezultatet biomjekësore ose të sjelljes, të lidhura me shëndetin.
c	<i>të dhëna të përbëra dhe të mbledhura</i> Të dhënat e mbledhura ose të përbëra nga disa burime shpesh heterogjene, të cilat kanë një ose disa pika të përbashkëta referuese, ku së paku një nga burimet është parapërgatitur për një qëllim tjetër. Këto të dhëna janë të përfshira në një entitet të ri (shih shembujt 2, 7). Shembull: sigurimi i të dhënave për numrin e universiteteve në njëqind e pesëdhjetë vitet e fundit duke përdorur burime të ndryshme që janë në dispozicion (dokumentet financiare, statistikat zyrtare, regjistrat e universiteteve), me kombinim të të dhënave të anketave nga statistikat zyrtare për zonat gjeografike (dendësia e banorëve, numri i mjekëve për banorë etj.) ose me përdorimin e protokollit RSS për mbledhjen e publikimeve në blogje ose twitter.
d	<i>të dhëna të koduara</i>

	Të dhënat kualitative (me tekst, video, audio ose fotografi), fillimisht të krijuara për qëllime të tjera, të konvertuara në të dhëna kuantitative (të shprehura në matrica sipas njësive) përmes përdorimit të teknikave të kodimit në përputhje me skemat e paracaktuara të kategorizimit. Shembull: kodimi i manifesteve politike të partive, siç është studimi për zgjedhjet në Parlamentin Evropian 2009 (doi:10.4232/1.10204).
e	<i>të dhëna eksperimentale</i> Të dhënat që janë rezultat i metodave kërkimore eksperimentale, me anë të të cilave administrohen disa ose të gjitha variablat e përfshira në hipotezë.
f	<i>të dhëna gjenomike</i> Të dhënat gjenomike kanë të bëjnë me gjenomin dhe ADN-në e një organizmi. Përdoren në bioinformatikë, ku mbledhen, ruhen dhe përpunohen gjenomët e gjallesave. Të dhënat gjenomike burojnë kryesisht nga teknikat e sekuencimit, mirëpo bëhet fjalë për një term më të gjërë se sa të dhënat sekuenciale. Mund të përmbajnë edhe të dhëna që nuk janë të lidhura me sekuencën, siç janë të dhënat nga mikrorrjetet, të dhënat nga panelet PCR në kohë reale dhe nga studimet farmakogjenomike (shih shembullin 3).
g	<i>të dhëna gjeohapësinore (të dhëna GIS)</i> Të dhënat gjeohapësinore janë të gjitha llojet e të dhënave me koordinata hapësinore, që mundësojnë vizualizimin e sipërfaqës tokësore. Mund të përfaqësojnë objekte fizike, zona të ndara ose sipërfaqe të vazhdueshme. Të dhënat e ndara gjeohapësinore zakonisht paraqiten përmes përdorimit të të dhënave vektoriale, të ndërtuara nga pikat, vizat dhe poligonët, ndërkohë që kur janë të lidhura ato shfaqen me të dhënat raster sikurse rrjeta e qelizave, në të cilën secila qelizë ka vlerën e saj. Disa aplikacione në fusha të ndryshme krijojnë të dhëna gjeohapësinore (siç janë: GIS, pajisja për detektim nga largësia, njësitë GPS, pajisjet për matje arkeologjike dhe gjeodezike, hartimi manual dhe dizajnimi kompjuterik (CAD)) në forma të ndryshme siç janë: fotografitë, vektorët, tekstet dhe të dhënat në tabela. Të dhënat vektoriale gjeohapësinore përfshijnë tabelat me listat e vendeve të gjetura arkeologjike me koordinatat e tyre, skedarët tekst (p.sh. XML) me koordinatat dhe tipologjinë e rrjeteve historike rrugore, rezultatet e votimit për partitë politike sipas zonave administrative. Të dhënat gjeohapësinore që bazohen në raster përfshijnë fotografitë satelitore, fotografitë nga ajri, hartat e skanuara dhe hartat digjitale të lartësisë/relievit sipërfaqësor, rritjen, përdorimin e tokës, temperaturën e sipërfaqës së detit, ndotjen e ajrit, llojet e tokës etj.
h	<i>fletore laborator, ditar kërkimor, shënime kërkimore</i> Ditari kërkimor është regjistrimi parësor i një hulumtimi. Kërkuesit shkencorë përdorin fletoret e laboratorit për dokumentimin e hipotezave të tyre, eksperimenteve dhe analizave paraprake ose interpretimet e këtyre eksperimenteve. Kodi përdoret si për fletoret e laboratorit tradicional ashtu edhe për ata elektronikë.
i	<i>të dhëna matëse dhe testuese</i> Të dhënat, të cilat janë rezultat i vlerësimit të vetive (ose karakteristikave) të caktuara të krijesave, sendeve e fenomeneve (dhe/ose proceseve) përmes përdorimit të standardeve të vlefshme dhe/ose instrumenteve apo teknikave të specializuara (shih shembullin 8).
j	<i>të dhëna vëzhguese</i> Të dhënat, të cilat janë rezultat i hulumtimit me vëzhgim, që përfshijnë mbledhjen e vëzhgimeve në kohë reale (p.sh. vëzhgimi i sjelljes, ngjarjeve, zhvillimit të gjendjes (shëndetësore) ose sëmundjes etj.), pa manipulim të variablave të pavarura.
k	<i>të dhëna të regjistruara</i> Të dhënat e regjistruara përmes pajisjeve mekanike ose elektronike në formën që mundëson anulimin dhe/ose riprodhimin e informacioneve. Shembull: fotografitë ose audiot në disk ose në shiritin magnetik (shih shembullin 4).
l	<i>të dhëna të simuluar</i>

	Të dhënat që rrjedhin nga simulimi i proceseve, ngjarjeve ose sistemeve në botën reale, shpesh me ndihmën e përdorimit të programeve kompjuterike (shih shembullin 5). Shembull: programi që simulon mënyrën e ndryshimit të konsumit në familje, bazuar në ndryshimet direkte të tatimeve; ose grupi i të dhënave për pacientët hipotetikë dhe ekspozimit të tyre ndar barërave, gjendjes fillestare të mjekimit dhe pasojave të njohura të dëmshme.
m	<i>të dhëna anketuese/hulumtuese</i> Të dhënat e marra nga hulumtimi, në të cilin përmes përdorimit sistematik të metodologjisë statistikore në modelin e përzgjedhur të popullsisë mblidhen të dhënat, hulumtohen dhe vlerësohen karakteristikat e caktuara të popullatës. Përfshihen regjistrimet e popullsisë, hulumtimet model, bazat e të dhënave nga evidencat administrative, aktivitetet e kryera statistikore dhe pyetësorët (shih shembullin 6).
z	<i>tjetër</i>

971b Të dhënat kërkimore – forma

Kodi përcakton formën e të dhënave kërkimore.

a	<i>koleksion i përfunduar</i> Koleksioni i të dhënave kërkimore është rezultat i një hulumtimi. Zakonisht publikohet si koleksion në një arkiv të besueshëm kombëtar ose ndërkombëtar të të dhënave (repositor). Duhet të jetë i disponueshëm për publikun dhe i dokumentuar në formën që mundëson përsëritjen e gjetjeve shkencore të publikuara. Cilësia e tij vlerësohet në bazë të të dhënave, metatëdhënave dhe dokumentacionit shoqërues gjithpërfshirës (p.sh. instrumenti matës, raporti për rrjedhjen e hulumtimit, informacioni për modelin, propozimi për pëlqimin, protokollin, programin; përmbajtjet mund të përshkruhen edhe në skedarin ReadMe, kur repositori nuk ka fusha të detajuara të metatëdhënave). Rëndësia e tij shkencore reflektohet në dobinë e tij për të hulumtuar një gamë të gjërë të problemeve aplikative ose të konceptuara në mënyrë teorike (shih shembullin 6).
b	<i>korpus</i> Korpusi është një koleksion i veçantë i të dhënave kërkimore, që është uniform, i përcaktuar me standarde, një koleksion i teksteve autentike i strukturuar nga brenda, i krijuar sipas kritereve të paracaktuara dhe me qëllim të caktuar, i disponueshëm në formë elektronike dhe i pajisur me mjete që mundësojnë kërkimin në shumë nivele dhe përpunimin statistikor të të dhënave (shih shembullin 7).
c	<i>grup/varg të dhënash</i> Grupi i të dhënave paraqet të dhënat e pjesshme dhe të paplota kërkimore, të publikuara në arkivin e të dhënave (repositor), me çka përmbushen parimet FAIR dhe mundësohet përsëritja e hulumtimeve. Të dhënat janë të pajisura me metatëdhëna, licencë, tregues të përhershëm dhe janë të përcaktuar në atë mënyrë që për përdoruesit të jetë e qartë paplotësia e tyre (shih shembullin 8).

SHEMBUJ

1. *

001	uu	an bl cm d0 t2.20
200	0u	aMaterials for HybridNeuro webinar titled "Validation of results: statistical models and MU identification accuracy" bBurim elektronik fAleš Holobar, Nina Murks
971	uu	aa ba

(Bëhet fjalë për një grup të vogël të të dhënave të agreguara për njësitë motorike reale dhe të simuluar.)

2. *

001	uu	an bl cm d0 t2.20
200	1u	aA †collection of IRONMAN, IRONMAN 70.3 and Ultra-triathlon race results bBurim elektronik fIztok Fister Jr., Dušan Fister
971	uu	ac bc <i>(Kodi "c" në nënfushën 971a tregon të dhënat që janë mbledhur nga disa burime elektronike. Në koleksion ndodhen rezultatet e ndeshjes IRONMAN, IRONMAN 70.3 dhe ultra-triatlon.)</i>

3. *

001	uu	an bl cm d0 t2.20
200	1u	aStaphylococcus epidermidis estrain COB [...] bBurim elektronik fStrancar V. ... [et al.]
971	uu	af ba <i>(Bëhet fjalë për një koleksion të përfunduar të të dhënave gjenomike.)</i>

4. *

001	uu	an bl cm d0 t2.20
200	1u	aA †collection of sport activity files for data analysis and data mining bBurim elektronik fSamo Rauter, Iztok Fister Jr., Iztok Fister
971	uu	ak bc <i>(Çiklistët kanë mbledhur të dhëna, të cilat i kanë eksportuar në koleksionin e të dhënave drejtpërdrejt nga llogaritë e tyre në Stravi ose Garmin Connectu në formën GPX ose TCX. Në grupin e të dhënave ndodhen: vendndodhja GPS, lartësia mbidetare, kohëzgjatja, distanca, rrahjet mesatare dhe maksimale të zemrës etj.)</i>

5. *

001	uu	an bl cm d0 t2.20
200	0u	aSimulated HDEMG data of biceps brachii muscle during isometric elbow flexion bBurim elektronik fSamo Rauter, Iztok Fister Jr., Iztok Fister
971	uu	al ba <i>(Bëhet fjalë për një grup të dhënash të simuluar HDEMG për muskulin biceps brachii.)</i>

6. * COBISS.net

001	uu	an bl cm d0 t2.20
200	1u	aMendimi publik sloven 2022/2 bBurim elektronik epasqyrë e mendimit publik, qëndrimi ndaj emigrantëve dhe integrimi i tyre, hulumtimi për shëndetin e trurit (Sinapsa), shëndeti dhe stili i jetesës fautorët kryesorë Hafner Fink Mitja... [et al.] gbashkëpunëtorët profesionalë Vovk Tina... [et al.] gskedarin e të dhënave e krijoi CJMMK - Qendra e Hulumtimit të Mendimit Publik dhe Komunikimit Masiv, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Universiteti i Lubjanës
971	uu	am ba <i>(Të dhënat e marra përmes anketës standarde janë publikuar si koleksion i përfunduar në arkivin e të dhënave ADP.)</i>

7. *

001	uu	an bl cm d0 t2.20
-----	----	-------------------

200	1□	a Slovenian parliamentary corpus (1990-2018) siParl 2.0 b Burim elektronik f Andrej Pančur ... [et al.]
971	□□	ac bb <i>(Korpusi siParl përmban procesverbale të organeve shtetërore dhe grupeve punuese të Republikës së Sllovenisë (më shumë se 10 mijë sesione, miliona fjalime apo 200 milion fjalë) për periudha të ndryshme. Përmban edhe të dhëna për folësit, tipologjinë e sesioneve etj., por edhe simbole strukturore, editoriale dhe gjuhësore.)</i>

8. *

001	□□	an bl cm d0 t2.20
200	0□	a Bi-hourly temperature and humidity measurements in blowhole 6N-3372 on the Nullarbor Plain, Australia b Burim elektronik f Lipar, Matej, Ferk, Mateja
971	□□	ai bc <i>(Bëhet fjalë për një grup të dhënash për matjen dyorëshe të temperaturës dhe lagështisë (nga nëntori 2019 deri në mars 2021) në katër shpella dhe në tre kanale të një prej zonave karstike më të thata dhe më të lidhura në botë – Nullarbor Plain në jug të Australisë.)</i>